



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SKËNDERAJT PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Bekim Jashari , Kryetar i Komunës së Skënderajt

Adresa: Rr. " 28 Nëntori " pn. 41000, Skënderaj, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Skënderajt për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Skënderajt (SK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Skënderajt, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Skënderajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të SK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se si rezultat i buxhetimit të gabuar, Komuna kishte bërë pagesa nga kategoritë jo adekuate. Përkatësisht:

- 57,956€ për Mallra e shërbime të cilat ishin paguar nga subvencionet dhe transferet, si rezultat, ishte mbivlerësuar kategoria e Subvencioneve e transfereve dhe nënvlerësuar kategoria e Mallrave dhe shërbimeve për këtë vlerë. Shpenzimet janë realizuar duke u bazuar në Marrëveshjen e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit mes Komunës dhe Caritas Kosova për projektin "Ngritja e përkujdesit për shërbime sociale dhe shëndetësore në shtëpi dhe ambulanta në Komunën e Skënderajt".
- 38,180€ për Subvencione e transfere (për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët) të cilat ishin paguar nga Mallrat dhe shërbimet, si rezultat, ishte mbivlerësuar kategoria e Mallrave dhe shërbimeve dhe nënvlerësuar kategoria e Subvencioneve dhe transfereve për këtë vlerë.

Përveç kësaj, Komuna kishte bërë edhe pagesa tjera nga kategoria e Mallrave e shërbimeve në bazë të vendimeve gjyqësore në shumë prej 270,602€ për kompensimin e pagave jubilarë, pagave përcjellëse, shujtave dhe shpenzimet tjera të procedurave gjyqësore. Si rezultat, ishte mbivlerësuar kategoria e Mallrave e shërbimeve dhe nënvlerësuar kategoria e Pagave dhe mëditjeve për të njëjtën shumë.

Kjo kishte ndodhur për arsyen se: 1. me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike; dhe 2. për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, detyrimet për paga në bazë të vendimeve gjyqësore nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera.

Duke qenë se çështjet në fjalë janë mjaft të përhapura në shumë organizata buxhetore dhe po përsëriten për vite me radhë, ato do të trajtohen më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë. Po ashtu, komuna kishte realizuar

pagesa nga Mallrat dhe shërbimet për tatimin në burim në shumë 57,859€, si dhe 78,512€ për kontributet pensionale, të cilat kanë rezultuar nga kompensimi i pagesave të shujtave. Si rezultat, ishte mbivlerësuar kategoria e Mallrave e shërbimeve dhe nënvlerësuar kategoria e Pagave dhe mëditjeve për të njëjtën shumë. Duhet theksuar se këto shpenzime nuk ishin të planifikuara.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Skënderajt.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Skënderajt është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Skënderajt në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Skënderajt me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Skënderajt.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (shih Grafikonin 1) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i shqyrtojmë këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2020 ishte 3,129,200€, prej të cilave ishin shpenzuar 2,581,206€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizime të ndryshme për zyre, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve etj. Kemi testuar 33 mostra për teste substanciale në vlerë 404,219€ si dhe pesë (5) mostra për teste (procedura) të pajtueshmërisë.

Çështja B1 - Dobësi në definimin e sasive në kontratat publike kornizë

Gjetja

Ligji i prokurimit publik 04/L-042 dhe Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik neni 56.10 sa i përket kontratave kornizë përcaktojnë se: Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë plus/minus tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar Autoriteti Kontraktues nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Te pagesa në vlerë 15,223€, sipas kontratës publike kornizë “Furnizimi dhe vendosja e kamerave në shkollat e Komunës së Skenderajt” e datës 26.12.2019, në vlerë 32,866€, kemi identifikuar se janë bërë tejkalime në tri pozicione në vlerë 8,144€, ngase në paramasë dhe parallogari të kontratës në këto pozicione ishte evidentuar sasia 1. Tejkalimi mbi sasinë 1 në këto tri pozicione ishte 3430m, 47 dhe 15 copë. Duhet theksuar se dukuria e mos definimit të sasive indikative për kontratat kornizë ishte trajtuar edhe në raportin e auditimit të vitit të kaluar.

Mospërputhjet mbi limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) përkatësisht mos definimi i sasive indikative të pozicioneve ka ndodhur për shkak të mangësive në kontrollet e brendshme lidhur me planifikimin dhe definimin e drejtë të kontratave.

Ndikimi Nënshkrimi i kontratave të pa definuara mirë sa i përket sasive përkatësisht tejkalmi i mospërputhjes së lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) për pozicione është në kundërshtim me kriteret e përcaktuara për kontrata publike kornizë, dhe si rrjedhojë mund të rezultojë me pagesa përtej buxhetit të planifikuar për ato projekte dhe vështirëson realizimin e projekteve tjera të planifikuara.

Rekomandimi B1 Kryetari të siguroj se gjatë përgatitjes së kontratave publike kornizë të planifikohen dhe të definohen drejtë sasitë për pozicione dhe çmimet e kontratave, në mënyrë që mospërputhjet eventuale mos të tejkalojnë limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Dobësi në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave

Gjetja Neni 62 i Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik (RrUOPP), për ndarje të detyrave, ndër të tjera përcakton se “Një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit”. Gjithashtu “Një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e references, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë si një anëtar i komisionit të vlerësimit”.

Në dy procese të zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave kemi identifikuar mangësitë në vijim lidhur me mos ndarjen e drejtë të detyrave:

Te aktiviteti i prokurimit “Servisimi i automjeteve zyrtare të Komunës së Skenderajt”, në vlerë indikative 50,000€, njëri nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të tenderëve ishte caktuar po ashtu edhe si menaxher i kontratës.

Te aktiviteti i prokurimit “Furnizim me material shpenzues, barna dhe paisje tjera për nevojat e QKMF-së dhe SHPMF-së në komunën e Skenderajt”, në vlerë 103,184€ personi i cili ka përgatitur paramasën ishte caktuar edhe anëtar i komisionit për vlerësimit e tenderëve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kujdesit të duhur në procesin e ndarjes së drejtë të detyrave përgjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit.

Ndikimi Caktimi i personave të njëjtë në disa procese në menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave mund të konsiderohet si konflikt interesi dhe reflekton negativisht në ndarjen e drejtë të detyrave, si dhe të ndikoj edhe në mbarëvajtjen e procesit.

Rekomandimi A1 Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave konform respektimit të kriterëve ligjore dhe rregullative të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 643,732€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 573,595€. Ato janë dhënë për entitete publike dhe jopublike dhe kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera në kuadër të komunës. Kemi testuar pesë (5) mostra për teste substanciale në vlerë 94,931€ si dhe pesë (5) mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 - Mos respektim i kriterëve gjatë vlersimit të aplikacioneve

Gjetja Sipas thirrjeve publike të dt. 02.07.2020 dhe 30.07.2020 për ofrimin e mbështetjes financiare për fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, ishte kërkuar kriteri për aplikim se “Para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se kanë të zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve”.

Nga testimi i thirrjeve publike për financimin e projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e sportit dhe kulturës, kemi identifikuar nëntë (9) raste në të cilat përfituesit janë shpërblyer me kontratë për mbështetje financiare në mungesë të dëshmimeve se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale. Prej tyre pesë (5) ishin në fushën e kulturës dhe katër (4) në fushën e sportit.

Kjo gjendje ishte si pasojë e mungesës së kontrolleve dhe pakujdesisë së komisionit të themeluar për vlerësimin e aplikacioneve.

Ndikimi Mungesa e dokumenteve për përmbushjen kriterëve në procesin e vlerësimit të aplikantëve, përveç që mund të dëmtoj kredibilitetin e procesit, mund të rezultojë që komuna bashkëpunon me OJQ/individë të pa përshtatshëm.

Rekomandimi B2 Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 151,332,009€, pasurive jokapitale është 316,757€, si dhe e stoqeve 35,183€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 4,522,441€, si dhe kemi kryer teste të pajtueshmërisë lidhur me procedurat e brendshme të menaxhimit të pasurive, inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive, funksionimin e sistemit e-pasuria etj.

Çështja C1 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fundvit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe, rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu, nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të nenit 21 të Rregullores 02/2013.

Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

Ndikimi Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Të arkëtueshmet

OB-ja në PFV e vitit 2020 ka shpalosur Llogari të Arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 1,177,345€. Kjo vlerë përbehet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, shfrytëzimi i pronës publike (renta dhe qiraja) si dhe lejet ndërtimore. Kemi testuar nëntë (9) mostra për teste substanciale në vlerë 38,132€.

Çështja B3 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme (LLA)

Gjetja Arkëtimi i të hyrave bëhet sipas afateve kohore të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Pjesa më e madhe e LLA i takon tatimit në pronë në vlerë 812,560€ rreth 69%, taksa komunale në biznes në vlerë 243,998€ rreth 21%, dhe shfrytëzimi i pronës publike (renta/qiraja) në vlerë 120,787€ rreth 10%. Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre vit pas viti. Në krahasim me vitin paraparak rritja ishte rreth 45,920€.

Nga analiza e të dhënave të prezantuara në PVF kemi evidentuar se llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në parcela nuk ishin prezantuar fare në PVF. Sipas sistemit Protax vlera e tyre në fund vitin 2020 ishte 80,780€.

Llogaritë menaxhohen nga sisteme të integruara (tatimi në pronë dhe taksa komunale në biznes), përderisa llogaritë për shfrytëzimin e pronës publike menaxhohen në excel dhe të dhënat e prezantuara mund të mos japin siguri të plotë për saktësinë dhe plotësinë e tyre.

Dobësitë e identifikuar lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë shkak i kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin e drejtë të tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me refleksion negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetjake.

Gjithashtu, kjo nuk ofron siguri për saktësinë dhe plotësinë e informatave të prezantuara në pasqyrat financiare.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2020, ishte 928,440€.

Çështja A2 - Mangësi në listen e detyrimeve kontigjente

Gjetja Lista e detyrimeve kontigjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë burimore që dëshmojnë vlerën e detyrimeve dhe se ato kanë të bëjnë me komunën.

Në dy raste me vlerë 5,900€ (3,200€ + 2,700€) komuna nuk ka ofruar dokumentet burimore që dëshmojnë pretendimet e palëve tjera ndaj komunës. Ndersa, në një rast tjetër kemi evidentuar se vlera e detyrimit kontigjent ishte paraqitur prej 18,634€, perderisa sipas dokumentacionit kemi vërejtur se duhej të ishte 20,726€. Rrjedhimisht vlera e detyrimit kontigjent ishte nënvlerësuar për 2,091€.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit të mirëfilltë mes zyrës ligjore (si përfaqësues i komunës) dhe sektorëve tjerë brenda komunës për evidentimin dhe regjistrimin e saktë të detyrimeve kontigjente.

Ndikimi Mungesa e dëshmimeve përkatëse për listën dhe vlerën e detyrimeve kontigjente, krijon paqartësi për komunën lidhur me pretendimet e palëve tjera ndaj detyrimeve komunale. Po ashtu, ndikon në mbivlerësimin apo nënvlerësimin e tyre në PVF.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se lista e detyrimeve kontigjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë përkatëse dhe të sakta, në mënyrë që dëshmojnë vlerën financiare dhe të sigurojë pretendimet e tilla kanë të bëjnë me komunën.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte një anëtarë dhe drejtorin. Mirëpo gjatë vitit auditori i brendshëm ishte transferuar në pozitën e tij paraprake. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë shtatë (7) auditime, përkatësisht gjashtë (6) auditime pas rishikimit të planit për shkak të pandemisë. Prej tyre, vetëm katër (4) auditime ishin përfunduar për shkak të ndikimit të pandemisë Covid 19 dhe stafit të pamjaftueshëm të NjAB-së. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit është 22, prej të cilave të zbatuara ishin gjashtë (6) në proces ishin dhjetë (10) dhe gjashtë (6) të pazbatuara. Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, pasurive dhe menaxhimit të tyre si dhe në fushën e të hyrave. Përderisa perioda e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2019. Komiteti i auditimit ishte plotësisht funksional dhe kishte mbajtur pesë (5) takime ku ishte diskutuar për raportin e auditorit të jashtëm dhe të NjAB.

Çështja B4 - Mos kompletimi i NjAB

Gjetja

Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë.

NjAB në Komunën e Skënderajt përbëhet vetëm nga drejtori.

Kjo gjendje ishte për shkak se njëri auditor i brendshëm ishte tërhequr nga NjAB si dhe për shkak të anulimit të konkursit për rekrutimin e një auditori të brendshëm.

Ndikimi

Mos kompletimi i NjAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi B4

Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,950,500	16,125,103	14,158,325	13,507,215	13,033,452
Grante Qeveritare – Buxheti	13,422,486	13,640,836	12,789,981	11,536,240	11,832,370
Financimi përmes huamarrjes	0	168,474	136,390	91,527	51,670
Të bartura nga viti i kaluar	0	750,149	561,316	586,075	138,213
Të hyrat vetanake	1,528,014	1,528,014	643,748	1,151,988	900,975
Donacionet vendore	0	9,012	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	28,618	26,890	141,385	110,224

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,174,603€. Kjo rritje ishte rezultat i rritjes së të hyrave të bartura nga viti paraprak për 750,149€, rritjes së grantit qeveritar prej 218,350€, rritjes se financimit nga huamarrja për 168,474€, donacioneve të jashtme për 28,618€ si dhe donacioneve të brendshme për 9,012€.

Në vitin 2020 OB ka shpenzuar 88% të buxhetit final ose 14,158,325€, me një rritje 5% në krahasim me vitin 2019. Shpenzimet gjatë vitit 2020 për menaxhimin e pandemisë Covid-19 ishin 500,462€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me kompensimin e pagave të stafit sipas vendimeve të nivelit qendror, shërbimeve tjera kontraktuese, përkrahjen e familjeve dhe bizneseve me pako ushqimore/financiare, pajisje nën 1000€, furnizime të ndryshme mjekësore etj. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,950,500	16,125,103	14,158,324	13,507,214	13,033,450
Pagat dhe mëditjet	7,824,425	8,117,827	8,117,827	7,687,208	7,490,289
Mallrat dhe shërbimet	1,650,640	2,916,714	2,398,184	1,564,420	1,374,212
Komunalitë	294,537	212,487	183,022	183,249	197,120
Subvencionet dhe transferet	300,000	643,732	573,595	552,047	349,047
Investimet Kapitale	3,773,140	4,234,343	2,885,696	3,520,290	3,622,782
Rezervat	1,107,758	0	0	0	0


Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë: Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 293,402€, prej tyre 178,067€ ishte nga granti i qeverisë (ku pjesa më e madhe ishte si rezultat i rishikimit të buxhetit të vitit 2020), 89,145 prej huamarrjes, si dhe 26,190€ nga të hyrat e bartura; Te mallrat dhe shërbimet, buxheti ishte rritur për 1,266,074€. Rritja kishte ndodhur si rezultat i vendimit të Kuvendit Komunal për transferimin e 139,000€ nga kategoria e investimeve kapitale në mallra dhe shërbime për menaxhimin e pandemisë, nga fondi i rezervave me rishikimin e buxhetit të vitit 2020 janë bartur 116,538€, nga fondi i rezervave por me vendime të kuvendit komunal buxheti i mallrave dhe shërbimeve ishte rritur edhe për 873,091€, nga programi i rimëkëmbjes për 87,788€, sipas vendimit të MAPL nga rezervat janë alokuar në mallra dhe shërbime 35,653€ për menaxhimin pandemisë Covid 19, nga të hyrat e bartura për 40,000€, nga huazimet për 31,731€ si dhe nga grantet e donatorëve 3,208€. Përderisa duhet theksuar se sipas vendimit të Ministrisë së Financave mallrat janë zvogëluar për 41,777€ si dhe 19,158€ sipas transferit të brendshëm.

Buxheti për shërbimet komunale ishte zvogëluar për 82,050€ si pasojë e vendimit të qeverisë;


Buxheti për subvencione ishte rritur për 343,732€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura për 297,442€, si dhe 46,289€ nga rritja e buxhetit sipas vendimeve për menaxhimin e pandemisë;

Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 461,203€, rritja ishte si rezultat i të hyrave të bartura 386,515€, prej mbështetjes financiare për menaxhimin e pandemisë 150,000€, nga huamarrja buxheti ishte rritur për 47,759€ si dhe pjesa e mbetur nga grantet bartura të donatorëve 34,469€. Duhet theksuar se buxheti i investimeve kapitale ishte zvogëluar për 157,540€ si rezultat i vendimit të Kuvendit Komunal për transferimin mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në mallra/shërbime dhe subvencione e transfere. Buxheti final ishte 4,234,343€ ndonëse duhet theksuar se buxheti i alokuar për vitin 2020 ishte 3,416,911€.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e përgjithshme të realizuara nga Komuna e Skënderajit në vitin 2020 ishin 660,933€ apo rreth 57% më pak se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 96,886€, dhe gjobat nga gjykatat 10,910€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,528,014	1,528,014	660,933	1,548,530	1,575,503
Të hyrat tatimore	254,568	254,568	189,768	272,870	222,450
Të hyrat jo tatimore	1,273,446	1,273,446	470,340	1,275,660	1,353,053
Të hyrat tjera	0	0	826		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Skenderajt ka rezultuar në 16 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2020, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar; katër (4) ishin në proces dhe pesë (5) nuk janë adresuar ende, siç është paraqitur më poshtë në Grafikon 4. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.	Komuna ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim dhe shpenzimet e varrimit ka filluar ti paguajë nga kategoria e subvencioneve, po ashtu shpenzimet për mallra për ofrimin e shërbimeve sociale/shëndetësore ka filluar ti paguajë nga kategoria e	Pjesërisht i zbatuar

			mallrave dhe shërbimeve. Mirëpo edhe gjatë vitit 2020 kishte pagesa për paga dhe mëditje nga kategoria e mallrave sikur në vitin e kaluar.	
2.	Pagat dhe mëditjet	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të siguroj se MSHV përdorën vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në Ministri të Financave gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.	Numri i stafit të angazhuar sipas MShV-ve gjatë vitit 2020 ishte 31. Komuna kishte marre masa që angazhimi i tyre të bëhej sipas ligjit të prokurimit. Kjo ceshtje nuk është trajtuar në raportin e këtij viti.	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Rekomandimi B2 Kryetari i komunës duhet sigurohet se gjatë përgatitjes së kontratave publike kornizë nga zyra e prokurimit, të përcaktohen saktë njësitë dhe çmimet e kontratave, devijimi +/-30% të përcaktohet në vlerën indikative e jo në vlerën e parashikuar të kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme që përmes raporteve periodike nga menaxherët e kontratave të mënjanoen tejkalimet eventuale të kontratave.	Edhe gjatë vitit 2020 kemi identifikuar raste të ngjashme.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Rekomandimi C2 Kryetari duhet të siguroj që menaxhimi i kontratave bëhet përmes hartimit të raporteve nga menaxherët përkatës për çdo lloj shërbimi dhe furnizimi, dhe se asnjë pagesë të mos ekzekutohet pa u siguruar dëshmitë e mjaftueshme se dispozitat e kontratës po zbatohen nga ana e operatorëve ekonomik (OE).	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Rekomandimi A1 Kryetari duhet sigurojë që do të kryhet servisimi i të gjitha aparateve të parapara sipas kontratës, dhe se zyrtarët përgjegjës në menaxhimin e kontratave dhe çertifikim të pagesave aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit	Të gjitha aparatet të parapara me kontratë ishin servisuar.	I zbatuar

		të parasë publike për tu siguruar se në të ardhmen nuk do të përseriten gabimet e ngjashme.		
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitetë	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të forcojë kontrollin në departamentin e prokurimit, për të siguruar që zyrtaret përgjegjës, të gjitha kërkesat për sqarime të tenderit dhe përgatitjen e dosjeve të tenderit/njoftimit për kontratë t'i bëjnë sipas kritereve të parapara ligjore.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
7.	Subvencionet dhe transferet	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë që procesi i vlerësimit të aplikuesve të dokumentohet me dëshmi përkatëse duke siguruar në të njëjtën kohë të mos shkelet parimi i konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të aplikuesve.	Edhe gjatë këtij viti kemi evidentuar mangësi në procesin e vlerësimit të aplikuesve dhe janë shpërblyer me subvencione në mungesë të dokumenteve përkatëse.	Nuk është adresuar
8.	Investimet kapitale	Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve janë në njohuri me kërkesat ligjore për prokurimin publik (kjo mund të bëhet me anë të trajnimeve) dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde të mjaftueshme që sigurojnë ekzekutimin e tyre, pa marrë parasysh nëse financimi i tyre është nga të hyrat vetanake apo fonde tjera të financimit.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
10.	Investimet kapitale	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe çertifikuesi aplikojnë kontrolle efektive në procesin e shpenzimit të parasë publike për tu siguruar se pagesat bëhen vetëm për punët/furnizimet e realizuara. Po ashtu, për punët e pakryera por të paguara, komuna duhet të	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar

		sigurohet se do të bëhet realizimi i tyre sipas kushteve kontraktuale, në të kundërtën duhet të bëhet kthimi i mjeteve financiare në buxhetin e komunës.		
11.	Investimet kapitale	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj që mos të fillohen projektet pa u siguruar për çështjet e problemeve pronësore. Të hartohen specifika adekuate të projekteve dhe menaxherët e kontratave të aplikojnë kontrolle efektive në menaxhimin e kontratave për tu siguruar se ato menaxhohen sipas planifikimeve të bëra paraprakisht. Duhet formalizuar procesin e zgjatjes së periudhës së ekzekutimit të kontratës sipas nenit 18 të dosjes së tenderit, si dhe të aplikohen penalet për vonesat e pa arsyetuara.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla gjatë vitit 2020.	I zbatuar
12.	Çështjet e përbashkëta	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFP.	2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale për aspektin e shpenzimeve të larta procedurale për shkak të pagesave të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqesore. Kjo çështje në këtë vit është trajtuar vetëm në kuadër të keqklasifikimit.	Nuk është i aplikueshëm më
13.	Pasuritë	Rekomandimi C3 Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se procesi i inventarizimi dhe vlerësimit të pasurive do të kryet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.	Edhe gjatë vitit 2020 kemi evidentuar mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare. Mirëpo duhet theksuar se nuk kishte mangësi në regjistrimin e blerjeve kapitale dhe jo kapitale të vitit 2020.	I zbatuar

14.	Llogaritë e arkëtueshme	Rekomandimi C4 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim.	Trendi rritës i llogarive të arkëtueshme ka vazhduar edhe në vitin 2020 dhe komuna nuk ka mundur të marr të gjitha masat përkatëse për arkëtimin e tyre. Po ashtu kishte gabime në shpалosjen e plotë të tyre në PVF.	Nuk është adresuar
15.	Obligimet e papaguara	Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle në ekzekutimin e pagesave, dhe në rast të paraqitjes së obligimeve të komunës, ato të jenë raportuar në mënyrë të plotë duke përfshirë të gjitha obligimet pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur.	Nuk kemi evidentuar vonesa në pagesën e faturave të vitit 2020.	I zbatuar
16.	Auditimi i Brendshëm	Rekomandimi C5 Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.	NjAB ende nuk ishte kompletuar me staf sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave në procesin e menaxhimit të aktiviteteve të prokurimit dhe kontratave konform respektimit të kriterëve ligjore dhe rregullative të prokurimit publik.
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të siguroj se gjatë përgatitjes së kontratave publike kornizë të planifikohen dhe të definojnë drejtë sasitë për pozicione dhe çmimet e kontratave, në mënyrë që mospërputhjet eventuale mos të tejkalojnë limitin e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%).
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari, duhet t'i forcojë kontrollet mbi menaxhimin e subvencioneve dhe të sigurojë që subvencionet ndahen në përputhje me kriteret e vendosura në thirrje publike.
4.	Pasuritë	Kryetari, duhet siguruar se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe më pas, të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat.
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime.

6.	Detyrimet Kontigjente	Kryetari duhet të sigurojë se lista e detyrimeve kontingjente duhet të jetë e bazuar mbi dëshmitë përkatëse dhe të sakta, në mënyrë që dëshmojnë vlerën financiare dhe të sigurojë pretendimet e tilla kanë të bëjnë me komunën.
7.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e NjAB.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Zukë Zuka, Udhëheqës i Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit





Arben Hundozi, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter Konfirmimi Skenderaj

04-400/01-0030743/21
28-06-2021

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE					
Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosovo	Op. Jedim. Org. Unit.	Shif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages	Komuna Skenderaj Opština Skenderaj Municipality of Skenderaj
04	17	1053	1		

Zyra e Kryetarit /Kabinet Gradonacelnika / Office of the Mayor

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Skenderaj, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Z. Bekim Jashari
 Zyrtari Kryesor Administrativ, Skenderaj
 Data: 28.qershor.2021

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁷ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.